



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

Numri i lëndës: 2023:055878

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492398

PPP.nr.966/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, si dhe me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri në çështjen juridike përmbarimore të kreditores Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco), me seli në Prishtinë, Bulevadri Bill Clinton nr.3, Ndërtesa Elektrokosova, Kati II Prishtinë, kundër debitorës T. L. me adresë rr..... nr. .... Prishtinë të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Av.Bajram Dili nga Prishtina, lidhur me çështjen përmbarimore pagesë e borxhit, vlera 3,450.57€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.361/15, të datës 18.02.2015, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 22.03.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **APROVOHET** pjesërisht i bazuar prapësimi i debitorës T.L nga Prishtina, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht urdhëri përmbarimor P.nr.361/15, i datës 18.02.2015 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi në Prishtinë dhe atë për periudhën 08.05.2013 deri me datë 19.12.2013, në shumë prej 1,495.39€.
- II. **REFUZOHET** prapësimi i debitores T.L, ashtu që Urdhëri Përmbarimor P.nr.361/15 i datës 18.02.2015 i Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi në Prishtinë, MBETET në fuqi për periudhën kohore nga data 05.01.2014 deri me datë 07.02.2015, për shumën e borxhit 1,955.18€, deri në përbushjen përfundimtare të detyrimit.
- III. Në rast se debitorja parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, **OBLIGOHET** që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës, ta paguaj garancionin në xhirrollogarinë e kësaj gjykate në shumën prej 1,955.18 € (Euro).
- IV. Në rast se debitorja dështon të paguaj shumën e lartcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

## A r s y e t i m

Përmbauesi Privat Isa Gacaferi në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbauesimin në bazë të Ekstraktit nga librat afarist në emër të T.L për periudhën 08.05.2013 deri me 07.02.2015, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit ti paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 3,567.72 Euro, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarisë bankare apo regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbauesimit, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke theksuar se nuk pajtohet me vendimin e marr nga ana e përmbauesit për arsye se leximi i njehsorit nuk është bërë asnjëherë nga ana e inkasantit për shkak se në atë orar nuk gjendet në shtëpi, kjo vërtetohet nga faturat që kanë ardh në vlerë prej 482.07€. Tutje ka shtuar se edhe shtëpia e debitorës si qdo shtëpi tjetër me standard të ulët është e pajisur me elemente të amvisërisë dhe në shumicën e kohës nuk gjendet në shtëpi, andaj ka kërkuar që edhe njëherë të bëhet verifikimi i faturave pasi që faturimet nuk janë reale.

Lidhur me këtë lëndë, gjykata ka zhvilluar procedurën në drejtim të vendosjes meritore lidhur me të njëjtën dhe me datë 14.06.2017 ka nxjerrë Aktvendimin PPP.nr.312/2015 me të cilin ka refuzuar prapësimin e debitorit. Në bazë të procedurës ankimore të zhvilluar sipas ankesës së debitorës, Gjykata e Apelit të njëjtën e ka gjetur të bazuar dhe përmes aktvendimit CA.nr.3620/2017 të datës 19.10.2014 e ka kthyer lëndën në rivendosje.

Pas pranimit të lëndës, analizimit të vërejtjeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe me qëllim të eliminimit të të njëjtave, gjykata në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së, ka vlerësuar të nevojshme caktimin e një seance dëgjimore dhe me datë 13.03.2024 ka mbajtur seancë dëgjimore ku kanë prezantuar të autorizuarit e palëve në procedurë.

I autorizuari i kreditorit Çlirim Rexhi në seancë dëgjimore ka theksuar se qëndron në tërësi pranë propozimit për përmbauesim kurse lidhur me pretendimet se leximi i njehsorit nuk është bërë me rregull ka theksuar se faturimi dhe leximi i njehsorit është bërë konform rregullores për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji të lëshuar nga ZRRE të Prillit 2017 ku në bazë të nenit 25 të kësaj rregullore debitorja është faturuar në mesataren e 3 faturave të fundit. Gjithashtu sa i përket parashkrimit të kërkesës ka theksuar se debitorja me pagesa të kohë pas kohëshme e që janë pagesa të borxhit të përgjithshëm e jo të specifikuar ka bërë ndërprerjen e parashkrimit në bazë të nenit 368 par.1 dhe 2 të LMD-së, pasi që këto pagesa nënkuptojnë pranim të borxhit në tërësi. Duke theksuar se në këtë procedurë vlen parimi rigorozitetit formal dhe nuk është procedurë kontestimore i ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi prapësimin e debitorës dhe urdhëri përmbauesimor të mbetet në fuqi sipas precizimit të bërë në seancë, dhe atë në shumën prej 3,450.57€.

I autorizuari i debitorës në seancë dëgjimore është deklaruar se në bazë të periudhës për të cilën kreditori e kërkon borxhin i njejtë është i parashkruar pasi që ka kaluar mbi 1 vit dhe në bazë të dispozitave të nenit 360 të LMD-së, ligjvënësi decidivisht ka paraparë se kërkesat për furnizim me energji elektrike parashkruhen në afat prej 1 viti. Ka shtuar se faturimi është bërë pa leximin e njehsorit dhe kjo rrethanë vërtetohet edhe nga ekstrakti i cili ka shërbyer si dokument përmbaues pasi që nga i njejtë vërteohet se për gjatë 6 muajve rresht të vitit 2013 debitori është faturuar nga 17.13 euro, në muajin nëntor 2013 është bërë një korrigjim ku është zbritur shuma prej 234.34 euro e menjëherë në faturën e po këtij muaji është faturuar shuma prej 1,225.62 euro, e duke pasuar pastaj fatura në lartësi prej 250.00 euro duke përfunduar faturimi në muajin Janar 2015 në shumë 482.07€. Gjithashtu ka theksuar se çdo herë faturimi është bërë pa lexim

të njëhisorit sepse nuk ka mundësi që për disa muaj rresht të harxhohen kilovatet e njëjtë dhe të faturohet shuma e njëjtë siç ka vepruar kreditori, andaj duke theksuar se besimi bllanko në dokumentet e ndërmarrjeve publike siç është kreditori është qëndrim i gabuar dhe në dëm të interesave të qytetarëve i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorës dhe të anulohet urdhëri përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të prapësimit, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim përgjigje në prapësim dhe mbajtjes së seancës dëgjimore, gjeti se prapësimi i debitorës është pjesërisht i bazuar.

Gjykata ka vlerësuar dokumentin e besueshëm – ekstraktin nga librat afariste DPR-110437, të datës 11.02.2015, në bazë të së cilës organi përmbarues ka zbatuar përmbarimin dhe ka vlerësuar se i njëjti paraqet dokumente të besueshëm dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1 pika 1.2 dhe par.3 e lidhur me nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe pas analizimit të këtyre pretendimeve në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit.

Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 360 paragraf 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*.

Kurse me nenin 368 paragraf 1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077) përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“ Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Po ashtu edhe me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton se, kërkesat për furnizim me energji elektrike parashkruhen brenda afatit prej një viti, ndërsa afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin kërkesa arrin për pagesë. Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim, se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2 të LMD-së. Kreditori ka kërkuar përmbarimin e borxhit për periudhën nga data 08.05.2013 deri me datë 07.02.2015, ndërsa propozimi për përmbarim është parashtruar me datë 16.02.2015. Bazuar në këtë, rezulton se borxhi i kreditorit pjesërisht është parashtruar, ngase nga dita kur janë bërë të arritshme kërkesat periodike për këtë periudhë, e deri në ditën kur është paraqitur propozimi për përmbarim datë 16.02.2015, kanë kaluar më shumë se një vit, dhe atë për periudhën 08.05.2013 deri me datën 19.12.2013 kërkesa e

kreditorit është e përfshirë në parashkrim, ndërsa për periudhën 05.01.2014 deri me datë 07.02.2015 gjykata vlerëson se nuk ka parashkrim të borxhit.

Deri tek shuma prej 1,495.38€ për të cilën është shfuqizuar urdhëri përmbarimor dhe shuma prej 1,955.18€ për të cilën është lënë në fuqi urdhëri përmbarimor, Gjykata erdhi në bazë të deklaramit të kreditorit i cili në seancën dëgjimore e ka precizuar lartësinë e borxhit duke kërkuar shumën prej 3,450.57€. Andaj Gjykata ka llogaritur se për faturimet e kreditorit për periudhën kohore nga data 08.05.2013 deri me datë 19.12.2013 ka parashkrim të kërkesës në shumën prej 1,495.39€. Në prani të këtyre rrethanave kur nga shuma totale e kërkuar nga kreditori prej 3,450.57 Euro, zbritet shuma e parashkruar prej 1,495.39 Euro, rezulton se për periudhën kohore nga data 05.01.2014 e deri me datën 07.02.2015, obligim i debitorës mbetet shuma prej 1,955.18 Euro, andaj, edhe nga këto arsye urdhri përmbarimor P.nr.361/15 i dt.18.02.2015, ka mbetur në fuqi në këtë shumë.

Gjykata e ka patur parasysh se nga ekstrati nga librat afarist për periudhën kohore nga data 05.01.2014 e deri me datën 07.02.2015, rezulton që debitorja të ketë borxh më të madhë tek kreditorja, mirëpo duke e patur parasysh se kërkesa e precizuar e debitorit për përmbarim ka patur vlerën prej 3,450.57 Euro (për tërë periudhën kohore nga data 08.05.2013 e deri me datën 07.02.2015), kurse është vërtetuar se nga kjo shumë është parashkruar shuma prej 1,495.39 Euro e cila i referohet periudhës kohore nga data 08.05.2013 deri me datë 19.12.2013, Gjykata lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka vendosur duke u kujdesur që të mos i kaloj kërkesat e kreditorës, por që të vendos brenda kërkesave të saja.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit lidhur me atë se faturimi çdo herë është bërë pa lexim të njehsorit sepse nuk ka mundësi që për disa muaj rresht të harxhohen kilovatët e njëjtte dhe të faturohet shuma e njëjte, mirëpo gjykata vlerëson të pabazuar këto pretendime pasi që debitori me asnjë provë materiale nuk i ka dëshmuar gjykatës se ka ndërmarrë ndonjë veprim duke inicuar procedurat e brendshme tek kreditori apo instancat gjyqësore në drejtim të vërtetimit të rrethanave se kreditori ka kryer shkelje përmes faturimeve të parregullta. Për më tepër Gjykata thekson faktin se meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale siç është procedura përmbarimore, me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejimit të përmbarimit, duhet kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit të besueshëm e që në rastin konkret ka qenë ekstrakti nga librat afarist DPR-110437, i datës 11.02.2015.

Në momentin e vendosjes gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimin e kreditorit se me kryerjen e pagesave të kohë pas kohëshme debitorja e propozimit ka bërë ndërprerjen e parashkrimit në kuptim të nenit 368 par. 1 dhe 2 i LMD-së, mirëpo gjykata vlerëson pagesat e kryera nuk mund të konsiderohen si pranim i borxhit pasi që ato janë pagesa të cilat i referohen shpenzimit të energjisë elektrike në përgjithësi e jo muajit përkatës. Për më tepër edhe sipas interpretimeve dhe konstatimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të dhëna në aktgjykimin e saj Rev.nr.148/2012, dt.09.09.2013, në një rast tjetër gjyqësor, me rastin e sqarimit të çështjes së ndërprerjes së parashkrimit me pagimin e borxhit, e njëjta gjykatë sqaron dhe konstaton se edhe pagesat e bëra të kohë pas kohe lidhur me borxhin periodik, nuk e bën ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ngase në rastin konkret borxhi për shpenzimet e energjisë elektrike është borxh periodik i cili arrin pas përfundimit të çdo muaji dhe afati i paraparë në nenin 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, për parashkrim rrjedh për secilin muaj nga momenti i përfundimit të atij muji, që do të thotë parashkrimi tek borxhi periodik që ka të bëjë me shpenzimin e energjisë elektrike, llogaritet në secilin muaj në mënyrë të veçantë.

Andaj, në prani të këtyre rrethanave gjykata arrin në përfundim se debitorja asnjëherë në asnjë rrethanë, me asnjë provë shkresore, nuk ka asnjë marrëveshje me kreditoren, me anë të së cilave ka bërë pranimin e borxhit i cili tani është objekt i përmbarimit, dhe si rezultat i kësaj gjykatës pretendimet e paraqitura nga debitorja në prapësim dhe gjatë seancës dëgjimore i kanë rezultuar pjesërisht si të bazuara.

Gjykata vlerëson se pjesërisht janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitje të prapësimit në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore ku si shkak për paraqitje të prapësimit parashihet: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi”*, e që në rastin konkret të çështjes juridike në fjalë është vërtetuar se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditores.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin vendosi që ta aprovoj pjesërisht në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore dhe vendosi si në pikën I, kurse pjesën tjetër të prapësimit e refuzoj si të pabazuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi debitoren që në rast të parashtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 1,955.18 €, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e paralajmëroi debitoren se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Nga të lart cekurat e duke u bazuar në dispozitat e nenit 73 të LPP, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -  
PPP.nr.966/17, dt.22.03.2024

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.